



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65 të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/03 prill 2017) dhe nenit 4, paragrafi 4.1, nenit 13, paragrafi 13.1, nënparagrafi d, ndërlidhur me nenin 15, paragrafi 15.7, nënparagrafi e, nenit 20, paragrafi 20.1, nënparagrafi d, dhe nenit 22, paragrafi 22.7, nënparagrafi e, të Ligjit Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.10/8 maj 2012), si dhe në zbatim të nenit 11 të Ligjit Nr. 05/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.3/17 janar 2017) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-115 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.25/07 shtator 2012) dhe Ligjin Nr.04/L-168 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.8/8 prill 2013), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM PËR FONDET PENSIONALE

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për Kontrolltet e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm për Fondet Pensionale, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 29 qershor 2017 (më tutje: rregullorja bazë).

Neni 2

1. Paragrafi 12 i nenit 9 të rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:
 12. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet:
 - 12.1. Të plotësojë kriteret e përcaktuara për drejtorë dhe/ose menaxherë të lartë të fondeve pensionale, në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - 12.2. Të jetë i certifikuar në fushën e auditimit nga ndonjë:
 - 12.2.1. institucion i akredituar në Kosovë për këtë qëllim;
 - 12.2.2. institucion i mirënjohur ndërkombëtar; apo
 - 12.2.3. institucion relevant i akredituar për këtë qëllim nga organi kompetent në vendin në të cilin është themeluar për ofrimin e shërbimeve të certifikimit në fushën e auditimit.

12.3. Të jetë individ me reputacion të lartë etik e profesional dhe me kualifikim e përvojë adekuate në fushën e auditimit.

Neni 3

Dispozitat kalimtare

Fondet pensionale duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj Rregulloreje brenda afatit prej 1 (një) viti nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Efektet dhe Hyrja në fuqi

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë mbesin në fuqi, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë Rregullore të cilat kanë efekt nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.
2. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e rregullores bazë.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 1 mars 2025.

Dr.sc. Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës